

18 TETOR

DITA BOTËRORE E MENOPAUZËS

Shoqata Ndërkombëtare e Menopauzës, në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, ka caktuar 18 tetorin si Ditën Botërore të Menopauzës.

Në këtë ditë, në mbarë botën organizohen aktivitete për të informuar gratë për menopauzën, ndikimin që ka në shëndetin e tyre, si dhe për menaxhimin e saj.

Simptomat e mundshme të menopauzës mund të kenë një ndikim negativ në cilësinë e jetës së përditshme. Për më tepër, pasojat e menopauzës mund të çojnë në një sërë sëmundjesh që lidhen me moshën, duke përfshirë sëmundjet e zemrës dhe osteoporozën.

Fushata botërore e ndërgjegjësimit për menopauzën thekson rëndësinë e vlerësimit të faktorëve të rrezikut specifik të femrat dhe parandalimin e zhvillimit të sëmundjeve (të zemrës, të qarkullimit të gjakut, etj.) si pasojë e menopauzës.

Dita Botërore e Menopauzës mund të jetë një thirrje për të zbatuar politika që mbështesin kërkimin dhe trajtimin në fushën e menopauzës.

Shoqata Ndërkombëtare e Menopauzës shpreson që vendet të shfrytëzojnë rastin e Ditës Botërore të Menopauzës për të nxjerrë në pah rëndësinë në rritje të çështjeve shëndetësore në menopauzë, si dhe për të inkurajuar gratë që të flasin me mjekët për menopauzën dhe efektet e saj afatgjata.

Për informacion mbi Menopauzën shiko: <http://www.ishp.gov.al/shendeti-riprodhues/>